



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Kamëz, më 09.04.2026

PROÇES-VERBAL - Tipi i kontratës - MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje karburanti”;

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 09100000-0 karburante;

Vlera e fondit limit: 1,666,156 (Një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor : **Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit, Kamez** (njësia e prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e përlogaritur të kontratës, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: *Ligjit nr.8438 date 28.12.1998, i ndryshuar.*

Shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Ndermarrja

Gjelbërimit, Parqeve e Rekreacionit Kamez, gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4/b, të nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur të thjeshtuar është përcaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se **20%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2. Operatori duhet të disponojë në pronësi/qira/marreveshje, të pakten 1 (një) stacion shpërndarje të karburantit brenda territorit të Bashkisë Kamëz, për të cilën duhet të paraqesë :

- a. Dokumentacionin e pronësisë të stacionit të karburantit.
- b. Vërtetimin teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike në fushën e tregtimit të naftës dhe nenprodukteve të tij.
- c. Licence për stacionin e shitjes së karburanteve (për tregti me pakicë).
- d. Në rast se stacioni i shpërndarjes të karburantit disponohet me qira/marrëveshje, përveç kontratës noteriale, duhet paraqitur edhe dokumentacionin i përcaktuar në pikat a,b,c.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët*

ekonomikë të regjistruhen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujq (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, datë.

09.01.2015”Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për lejet e Mjedisit”, të ndryshuar.

Kerkesa per disponimin **1 (një)** stacion të shitjes me pakicë në territorin e **Bashkisë Kamez** lidhet me shtrirjen e madhe territoriale te Bashkise Kamëz, numrin e konsiderueshëm të mjeteve, shpërndarjen e mjeteve në territorin e **Bashkise Kamëz** për kryerjen e detyrave funksionale që ato kanë dhe uljen e konsumit te panevojshem te karburantit per furnizimin me karburant.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktet e kërkuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i certifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standartet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar jo më herët se **3 (tre)** muaj nga data e hapjes së ofertave. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter eshte vendosur bazuar ne Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel” pasi AK kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen më standartet teknike te kërkuara.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjisllacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit nga data e zhvillimit të procedurës. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër që të pajisë autoritetin kontraktor me kartë elektronike për furnizimin me karburante (VKM nr.561, datë 29.7.2016), sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër furnizimin me karburante sipas standarteve në fuqi, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe me shërbim 24 orë NON STOP sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik fitues duhet të marrë përsipër prodhimin e kartës/ave elektronike si dhe të ofrojë programin kompjuterik që mundëson furnizimin me karburant të mjetit/eve. Vlefshmëria e kartës elektronike të lëshuar nga firma furnizuese duhet të jetë e vlefshme deri në përfundim të sasisë së karburantit të prokuruar.

Argumentimi: Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshëm”.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

A. Specifikimet teknike për mallin Gazoil D1(10ppm) objekt prokurimi: “Blerje karburanti”

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Evropiane të lëndëve djegëse 98/70/EC, amendamentit 2003/17/EC, amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diezel”.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min.	Max.	
1	Numri i Cetanit	-	51	-	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN5195 SSH EN16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	-	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	kg/m ³	820	845	SSH EN ISO 3675 dhe 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	-	8	SSH EN ISO12916

5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	-	10.0	SSH EN ISO 20846, SSH EN ISO 13032, SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e manganit nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	-	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55	-	SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni	% (m/m)	-	0.30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	-	0.01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	-	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	-	24	SSH EN ISO 12662
12	Gërryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 °C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	-	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë(wsd 1.4) në 60 °C	um(microm)	-	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskoziteti në 40 °C		2000	4500	SSH EN ISO 3104
17	Distilimi % vol e destilati që vlon deri ne 250°C % vol e destilati që vlon deri ne 350°C Distilati që vlon në 95% vol.	% (v/v) % (V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

Tab. nr. 1

- Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përveç deklaramit nga ana e operatorit ekonomik, do të shoqërohen edhe me flet analizën përkatëse, e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuari i tij, dhe në përputhje me Standardin S.SH.EN 590:2025.

BENZINE (Premium Unl 10 ppm)

Benzina analizohet sipas standartit SSH EN 228:2025

Nr	Treguesit	Njesia matjes	Kufijte		Metoda e Testimit
			Minimum	Maksimum	
1	Numri i oktanit kerkimor RON		95		ASTM D 2699-23
2	Numri i oktanit motorrik MON		85		ASTM D 2700-23
3	Densiteti ne 15 °C	kg/m ³	720,0	775,0	S SH EN ISO 12185:2024

					S SH EN ISO 3675:1998 ASTM D 4052-22
4	Permbajtja e sqfurit	mg/kg	-	10,0	SH EN ISO 20846:2019 S SH EN ISO 2160:1999
5	Korozioni i shufres se bakrit (3 ore / 50 °C)	Renditje	Klasa 1		
6	Tensioni i avujve	kPa			S SH EN 13016-1:2024
7	Pamja e jashtme		E paster dhe e tejdukshme		
8	Destilimi				
a	Distilon deri 70 °C	% v/v	20	48	S SH EN ISO 3405:2019
b	Distilon deri 100 °C	% v/v	46,0	71,0	S SH EN ISO 3405:2019
c	Distilon deri 150 °C	% v/v	75	-	S SH EN ISO 3405:2019
d	Pika finale e distilimit	°C	-	210	S SH EN ISO 3405:2019
e	Mbetjet e distilimit	% v/v	-	2	S SH EN ISO 3405:2019
9	Permbajtja e tipit te hidrokarburit				
a	Olefinat	% v/v	-	18,0	S SH EN 238:1996/A1:2003
b	Aromatiket	% v/v	-	35,0	S SH EN 238:1996/A1:2003
10	Permbajtja e benzenit	% v/v	-	1,0	S SH EN 238:1996/A1:2003
11	Permbajtja e oksigjenit	%(m/m)	-	2,7	S SH EN 238:1996/A1:2003
12	Permbajtja e komponimeve oksigjenore				
a	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3	ASTM D 5845-21
b	Etanol (alkool etilik)			5	ASTM D 5845-21
e	Alkool terc - butil			Perzierja ne vellim i kufizuar ne 2.7 % (m/m) te permbajtjes maksimale te oksigjenit	ASTM D 5845-21
f	Komponime oksigjenore te tjera				ASTM D 5845-21
g	Etere (me 5 ose me shume atome C)				ASTM D 5845-21

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e

nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: Specifikimet teknike, janë hartuar për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë elementët më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe Direktivës Evropiane të lëndëve djegëse 98/70/EC, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance dhe çdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare për automjetet.

Njësia e Prokurimit